

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
STUDIMET PASUNIVERSITARE – MASTER
PROGRAMI ARKIVISTIKË



REZYME E TEMËS SË MASTERIT

me titull:

APLIKIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE ARKIVORE NË ARKIVIN
NDERKOMUNAL TË PRISHTINËS

Kandidati:

Driton Berisha

Mentor:

Prof. Asoc. Dr. Muhamet Qerimi

Shtator, 2024

Përmes studimit të kësaj teme jemi përpjekur të japi një kontribut modest në lëmin e arkivistikës, duke paraqitur rëndësinë e Arkivit Ndërkomunal të Prishtinës e trajtimit dhe menagjimit të dokumenteve zyrtare-arkivore në arkivat e institucioneve të vendit, me theks të veçanët standardet ndërkombëtare të aplikueshme në këtë arkiv, krijimin dhe ruajtjen e lëndës arkivore sipas standardeve ndërkombëtare, historikun e veprimtarisë arkivore në Kosovë, legjislacionin arkivorë, masat a preventive në ruajtjen dhe mbrojtjen e lëndës arkivore, deri të e drejta ligjore për qasje në dokumentet arkivore-publike dhe hulumtimi në arkiva.

Arkivat sikurse në gjithë botën ashtu edhe në Kosovë janë institucione të karakterit publik, të cilat posedojnë dokumentacionin unikat për ngjarjet, shoqërinë njerëzore si vepra të trashëgimisë kulturore, historike të vendit ku veprojnë, arkivat ruajnë përjetësinë e kujtesës njerëzore, thesarin kulturor të një populli, treve, vendi apo institucioni.

Nisur nga fakti se arkivi apo arkivat në përgjithësi përbëjnë kujtesën e kombeve dhe të shoqërive, ato përbëjnë bazën e identitetit të tyre dhe janë një element thelbësor i shoqërisë së informimit të lirë. Kësisoj Arkivi Ndërkomunal i Prishtinës kujdeset për përparimin dhe zhvillimin e mëtejshëm, si në teknologjinë e punës profesionale, ashtu edhe në krijimin e parakushteve për realizimin sa më efikas në mbrojtjen, rregullimin, përpunimin dhe shfrytëzimin e lëndës arkivore. Këto parakushte janë: sigurimi dhe aftësimi i kuadrit profesional; kushtet e vendosjes për punë dhe ruajtje të lëndës arkivore; përparimi zhvillimi i punëve në menaxhimin administrative zyrtar të krijuesit të lëndës arkivore; përdorimi i teknologjisë bashkëkohore dhe pajisjeve në arkiva; përcaktimi i normave dhe standardeve për punën profesionale, kuadrin, lokalet, pajisjet, normat e punës profesionale, planifikimi, kultivimi dhe përparimi i proceseve integrale si parakushte për realizimin e funksioneve të arkivave.

Arkivistika përfaqëson një fushë të veprimtarisë shoqërore dhe përfshin problemet teorike dhe praktike që kanë të bëjnë me administrimin e dokumenteve të llojeve të ndryshme.

Veprimtaria e arkivit është pranimi, ruajtja, rregullimi dhe përpunimi, hartimi i mjeteve informative shkencore, mikrofilmimi, digjitalizimi dhe publikimi i dokumenteve të cilat gjenden në fondet dhe koleksionet arkivore. Punimi në mes tjerash trajtojnë çështjet të lidhura me “Aplikimi i standardeve ndërkombëtare në Arkivin Ndërkomunal të Prishtinës” që nga krijimi i tij si institucion shtetëror me karakter juridik dhe fizik, pastaj për shërbimin mbrojtës, fondet arkivore të kësaj komune si dhe dokumentet kulturore.

Punimi është i ndarë në tre kapituj. Kapitulli i parë i temës paraqet themelimin përkatësisht historikun dhe zhvillimin e arkivave në Kosovës, këtu do të përmbledhim vështirësitë e themelimit dhe rëndësinë e arkivave për dokumentacionin e krijuar, themelimin e Arkivit Ndërkomunal të Prishtinës.

Në Kapitullin e dytë do të flasim për fondet arkivore ku do të cekim disa fonde të Arkivit Ndërkomunal të Prishtinës, klasifikimin e fondeve dhe koleksioneve.

Në kapitullin e tretë kemi trajtuar aplikimin e standardeve e standardeve ndërkombëtare, ruajtja e dokumenteve sipas standardit ndërkombëtarë ISO-15489, termat dhe definicionet, Standardi ndërkombëtar për përshkrimin e institucioneve më lëndë arkivore ISAD (G).

Si për mënyrën e pranimin dhe mbrojtjes së lëndës arkivore, po ashtu edhe dokumenteve me karakter kulturor, duke dhënë informacione të përgjithshme mbi teorinë bashkëkohore të përcaktimit të këtij institucioni me një rëndësi të veçantë historike dhe kulturore të një populli.

Ndër tjera është trajtuar mënyra e arkivimit elektronik të dokumenteve dhe arkivat, me theks të veçantë Standardet arkivore ndërkombëtare të aplikueshme në arkivat e Kosovës.

Një prej detyrave parësore të shërbimit arkivor në vendin tonë ka qenë dhe është mbrojtja e lëndës arkivore të krijuesit dhe poseduesit, pranimi dhe vendosja e saj në arkiv deri të shfrytëzimi apo qasja.

Gjatë punës sime deri në finalizimin e këtij punimi, kam bërë hulumtime në vjeljen e burimeve të dorës së parë, burime shkencore të botuara, dokumente të rëndësishme të veçantë në fushën e arkivit (të pabotuara), ligjet dhe aktet tjera relevante, standardet ndërkombëtare, dokumente arkivore, revista, artikuj, dorëshkrime si dhe burime të tjera.